

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve/ Rrëzohet kërkesa e PD për tërheqjen e draftit të PS! Bardhi: Rrezikojmë të shkeli m Kushtetutën! Balla: Hipokrizi! (VIDEO)
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/pagat-e-magjistrateve-rrrezohet-kerkesa-e-pd-per-terh-eqjen-e-draftit-te--i586633
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:11:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8df076a87b43c9fa25242a8195c0f338279f48131dd7e0043b1bbdb31d874274
TEKSTI	a44b9c82d8ab3317b80bc0a2150eeae9073d2f306865261796d34383d3d2f16
PAMJA	aae18d5526a3b7c3b49b90b400dbbac64dbf625d6adb1ef85b2a477e61a1a3e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0f39966351a5ddceeb2672507c11d40b5f16b671d5808d8a1790a5874b5225dc
E MËPARSHMJA	6e17e7ee642455eb31660b3b2949f5008bc9fff8cfcb59f08aa470119aeb98a4
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0f39966351a5ddceeb2672507c11d40b5f16b671d5808d8a1790a5874b5225dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 te prekur e dy viktima në Frankfurt Brazil, presidenti Lula i ben apel Ancelottit: Merr me shume futbolliste qe luajne ne f fundit

Pagat e magistratëve/ Rrëzohet kërkesa e PD për tërheqjen e draftit të PS! Bardhi: Rrezikojmë të shkelim Kushtetutën! Balla: Hipokrizi! (VIDEO)



17 Shtator 2026, 11:10Politika TEMA




Partia Demokratike i kërkoi Partisë Socialiste të tërheqë nga rendi i ditës draftin për formulën e re të pagave të magistratëve.

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, tha se duhet të vijojnë konsultimet me institucionet e drejtësisë, pasi, në të kundërt, sipas tij, ligji rrezikon të miratohet sërish në shkelje të Kushtetutës.

"Sot në Kuvend është një çështje shumë e rëndësishme për magistratët, e mbartur prej 7 vitesh. Ka 3 vendime të Gjykatës Kushtetuese që mazhoranca juaj ka refuzuar t'i zbatojë, ose më saktë, i ka shkelur. Gjatë kohës kur ne diskutojmë në komisione, na kanë ardhur opinionet e institucioneve të drejtësisë. Versioni juaj nuk është konsultuar. Jeni para përgjegjësisë për ta tërhequr sot, sepse rrezikojmë të shkelim Kushtetutën. Duhet të marrim kohën e mjaftueshme që ky Kuvend të marrë një vendim për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare. Nuk mund t'i mbajmë të pasigurt në trajtimin financiar, sepse nuk do t'i shërbenin si duhet vendit. Ndaj tërhiqeni, të bëhet vlerësimi i projektligjit e më tej të veprojmë", tha Bardhi.

Në përgjigje, kryu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, e cilësoi hipokrite kërkesën e PD-së, e cila u rrëzua me 79 vota kundër. Balla tha se është lajm pozitiv që opozita del në mbrojtje të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke iu referuar kritikave dhe akuzave të saj të mëparshme ndaj drejtësisë.

"Kuvendi, që nga viti 1998, ka një praktikë të konsoliduar sa i përket procedurës që ndjek në transpozimin e vendimeve të Kushtetueses. Këshilli i Legjisllacionit e ka përfunduar detyrën e vet. Madje, Kushtetuesja duhet të marrë shembull nga Këshilli ynë i Legjisllacionit. Më vjen mirë të dëgjoj që PD del në mbrojtje të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky është lajm pozitiv, sepse tregon reflektim nga ato sharje dhe kërcënime që jemi mësuar t'i dëgjojmë shpesh. Sot jemi këtu për të votuar një projektligj. Vota jonë ndaj kërkesës së PD-së është kundër. Është kërkesë hipokrite. Më thanë që jemi vonuar dhe tani që e kemi sjellë, na thonin ta shtyjmë", tha Balla.



7 Komente

9

90% e popullit eshtw kundra pages horrave

17 Shtator 2026, 11:19

Te behet referendum per pagat e ketyre horrave qe nuk bejne 5 leke pune e marin 10000 euro

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 12 🗳️ 0 ❤️ 0

X

XXX

17 Shtator 2026, 11:45

Po te bejme referendum qe ta bejme Ramen edhe Ali edhe Kadi

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 6 ❤️ 0

A

Argita Pr Dr ne Fakultetin Juridik.....

17 Shtator 2026, 12:49

Jetoj 36 vjet ne Gjermani. Kemi nje biznes ku jane te punesuar dhe shume Studente.Njera prej tyre eshte Prokurore ne Stuttgart qe prej 10 vjetesh.E pyeta nqs me lejon sa paguhet,? Pa problem me tha 4-6mije €.Imigjino ne nje Shtet qe Hajdutet quhen Prokurore duan mbi dhjetmije€ ne Shqiperi dhe keta qelbesira duhet te mbrojne parat e shtetit nga Krimi. Institucionet e Drejtesise ne Shqiperi duhet tu veshe flaken me Benzin ose dinamit.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0

S

Sass

17 Shtator 2026, 12:01

Baz Gardhi te ka filluar suma te kruhet por nje dite do ta gjesh partnerin. Pederast

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 6 🗳️ 0 ❤️ 0

S

Sqli metaaj

17 Shtator 2026, 12:12

O re 3x ti ke hallin e rames apo te lekeve se po moren kta horra 100 milion euro ec e kerko k.... e rames meqense e ke qef.

← [Përgjigjuni](#)

👍 4 🗳️ 0 ❤️ 0



PD

17 Shtator 2026, 12:52

o Bardho, pse je kaq gej mer plak?

← [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



Meleq Sinani

17 Shtator 2026, 12:58

O Gaz Bardhi po ti gjoja je me popullin fukara si ka mundësi që bëhesh me kta kriminelët e drejtësis si ? ? ?

← [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shqipëria dënon vendimin e Hagës/ Deklaratë e përbashkët në Kuvend kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së \(VIDEO\)](#)

10:47 Politika / 15 komente

[Presidenti Begaj dekreton Ervin Demon si ministër të Brendshëm](#)

10:35 Politika / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.